



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr.2004/13

Prishtinë, më 8 dhe 9 shtator 2004

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Bajram Kosumi, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 81 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbali të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat sendore;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për familjen;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për konkurrencën
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prodhimtarinë blegtorale;
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për inspeksionin e arsimit;
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër korrupsionit;
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lojrat e fatit;
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor;
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shpalljen e kompleksit memorial "Adem Jashari", me interes të veçantë kombëtar;
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për avokatinë;
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financimin e partive politike;
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtaritë kërkimore-shkencore;
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tubimet publike
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zejtarë;
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat e autorit;

17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen e të papunësuarëve;
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për librin amzë;
19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e vulave të IPVK-ve;
20. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për "Gazetën zyrtare" të Kosovës;
21. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për administratën tatimore dhe procedurat;
22. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patenta;
23. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për teatrin;
24. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës dhe
25. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimin privat në shëndetësi.

Në fillim të seancës deputeti **Bedri Selmani** tha se Kuvendi në seancën e mëparshme e kishte hequr nga rendi i ditës shqyrtimin e Projektligjit për nxitjen e investimeve me arsyetim se sponsoruesi i tij (deputeti Selmani) dhe Qeveria e Kosovës t'i harmonizojnë tekstetet e projektligjit (Qeveria ishte duke e hartuar një projektligj të kësaj fushe) dhe të shqyrtohet në seancën e ardhshme. Meqenëse nuk kanë mund t'i harmonizojnë tekstet e projektligjit, ngase Qeveria nuk e ka propozuar ndonjë projektligj të kësaj fushe, andaj kërkoi që në seancën e sotme të shqyrtohet Projektligji për nxitjen e investimeve.

Kryetari e hodhi në votë propozimin e deputetit Bedri Selmani. Rezultati ishte si vijon:

Për-----34.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës nuk e miratoi propozimin e deputetit Bedri Selmani për ta shqyrtuar në seancën e sotme Projektligjin për nxitjen e investimeve.

Deputetja **Flora Brovina**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi që Kuvendi në seancën e sotme ta shqyrtojë si pikë të veçantë edhe sjelljen e policisë së UNMIK-ut kundër protestuesve dhe familjarëve të personave të rrëmbyer dhe të pagjetur të mbajtur më 31 gusht 2004.

Kryetari tha se e përkrah shqetësimin e deputetës Brovina, si dhe qëndrimet e Komisionit për Personat e Rrëmbyer dhe të Pagjetur lidhur me sjelljen e policisë së UNMIK-ut kundër protestuesve, Kuvendi i mbështet.

Ai e hodhi në votë propozimin e deputetës Flora Brovina. Rezultati ishte si vijon:

Për-----41.

Kryetari konstatoi: Kuvendi nuk e miratoi kërkesën e deputetës Flora Brovina që në seancën e sotme të shqyrtohet sjellja e policisë kundër protestuesve më 31 gusht 2004.

Deputetja **Hatixhe Hoxha**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi që Kuvendi në seancës e sotme ta shqyrtoj edhe çështjen e ART-së lidhur me tenderin për telefoninë mobile.

Kryetari e hodhi në votë propozimin e deputetës Hatixhe Hoxha. Rezultati ishte si vijon:
Për-----33.

Kryetari konstatoi: Kuvendi nuk e miratoi propozimin e deputetës Hatixhe Hoxha për ta radhitur në seancën e sotme çështjen e ART-së.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat sendore

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit Funkcional lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e deputetit Fatmir Sejdiu dhe të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kushtetutë të Përkohshme.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43 dhe 44.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----80;

Kundër----- 1;

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për të drejtat sendore.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për familjen

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit Funkcional lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e deputetes Nerxhivane Dauti të përkrahura nga Komisioni Funkcional.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----81;

Kundër----- 0;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për familjen.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për konkurrencën

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Tregti dhe Industri - Komision FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40 dhe 41.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----80;
Kundër----- 1;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për konkurrencën.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prodhimtarinë blegtorale

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - Komision FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----71;
Kundër----- 0;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për prodhimtarinë blegtorale.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër korrupsionit

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe të Komisionit për Ekonomi dhe Financa.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----70;
Kundër----- 1;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin kundër korrupsionit.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lojërat e fatit

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Komisioni për Ekonomi dhe Financa – komisione funksionale.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 78;
Kundër----- 1;
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për lojërat e fatit.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për inspeksionin e arsimit

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Teknologji - Komision FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Kryetari e hodhi në votë Proektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----76;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për inspeksionin e arsimit.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat dhe për përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Shëndetësi-Komision FunkSIONAL.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----76;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për të drejtat dhe për përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shpalljen e kompleksit memorial “Adem Jashari” me interes të veçantë kombëtar

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit FunkSIONAL lidhur me këtë projektligj.

E hodhi në votë amendamentin e propozuara nga Komisioni për Buxhet.

Kuvendi e miratoi amendamentin e propozuar nga Komisioni i Buxhetit.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për-----76;
Kundër----- 0;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për shpalljen e kompleksit memorial “Adem Jashari” me interes të veçantë kombëtar.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për avokatinë

Kryetari i informoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të veçanta dhe të Komisionit Funkcional lidhur me këtë projektligj.

I hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kushtetutë të Përkoshme - Komision Funkcional.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin në tërësi. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 75;
Kundër----- 0;
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për avokatinë.

Kryetari propozoi që Kuvendi t’ia dërgojë një **telegram** ishpresidentit të SHBA-ve, z. **Bill Clinton**, i cili ditë më parë i ishte nënshtruar një operacion të zemrës. Kuvendi në shenjë mirënjohje dhe falenderimi për mbështetjen e tij çështjes së Kosovës i dëshiron shërim sa më të shpejt dhe suksese në punët e ardhshme. Deputetët me aklamacion e përkrahën propozimin e kryetarit.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zeytari

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ali Jakupi: Projektligji për zeytarinë paraqet një dokument të rëndësishëm me të cilin rregullohen kushtet për ushtrimin e veprimtarisë zeytare, si bie fjala regjistrimi i veprimtarive biznesore, ushtrimi i përbashkët, aftësimi, edukimi, kultivimi i zejeve të vjetra – që janë të dobishme dhe fitimprurëse, mbikëqyrja e veprimtarisë zeytare. Projektligji është hartuar me 58 nene, përkatësisht me 6 kapituj.

Në kapitullin e parë, janë të definuara normat dhe fushëveprimtaria e zeytarisë. Në kapitullin e dytë, saktësohen mundësitë e ushtrimit të kësaj veprimtarie për personat fizik vendës dhe ata ndërkombëtarë. Është rregulluar mundësia për ushtrim të përbashkët

të veprimtarisë së zëjtarit – dy e më tepër persona fizik. Veprimtaria zëjtare mund të ndërpritet vullnetarisht ose me forcën e ligjit.

Në kapitullin e tretë, përfshihet domosdoshmëria e arsimimit dhe për ushtrimin e veprimtarisë zëjtare kërkohet përgatitja e duhur profesionale, që arrihen në institucionet shkollore të mesme e të larta dhe superiore.

Në kapitullin e katërt, rreglohen mundësitë e themelimit dhe të organizimit të shoqatave zëjtare në aspektin territorial apo aspektin e llojit të veprimtarisë.

Kapitulli i pestë, përmban dispozitat mbikëqyrëse dhe të masave ndëshkuese. Mbikëqyrjen e bën ministria kompetente dhe inspeksioni i autorizuar.

Kapitulli i gjashtë dhe përmbyllës i këtij projektligji përfshin dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Në përfundim të arsyetimit, ministri Ali Jakupi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj, dhanë e dhe këta deputetë: **Gani Prekopuca, Bajrush Xhemajli dhe Sebahate Krasniqi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----77;

Kundër----- 0;

Abstenime--- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për zëjtari. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin për Tregti dhe Industri** – komision raportues – ta shqyrtonin këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për administratën tatimore dhe procedurat

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë propjektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ali Sadria: Projektligji për administratën tatimore dhe procedurat vendos rregullat dhe procedurat gjithpërfshirëse për administratën tatimore dhe kontributet tashmë të vendosura në legjislacion efektiv të Kosovës, e që janë në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Ky Projektligj është hartuar në bazë të përvojave të deritanishme të administratës tatimore, por të korrigjuara dhe të avancuara në disa fusha, me qëllim të krijimit të bazës juridike për ngritjen e administratës tatimore në nivel më të lartë sipas formave të avancuara evropiane.

Projektligji ndahet në 14 pjesë me gjithsej 67 nene.

Pjesa e parë, parasheh themelimin e administratës tatimore të Kosovës, si një Agjenci e veçantë brenda Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

Pjesa e tretë, rregullon lëminë e numrave identifikues tatimor, sipas të cilëve obligohen tatimpaguesit që të jenë të pajisur me numrin identifikues.

Pjesa e katërtë, e pestë dhe gjashtë, rregullojnë regjistrimet tatimore, deklaratat tatimore dhe pagesat tatimore. Gjithashtu, kjo pjesë rregullon në mënyrë të detajuar pagesën e tatimit, afatet kohore si dhe vendi në pagesës.

Pjesa e shtatë, përcakton autoritetin e administratës tatimore në mbledhje të detyrueshme të tatimit nga tatimpaguesit delikuent.

Pjesa e tetë, përcakton veprimet që duhet të mirren ndaj shmangies tatimore, përkatësisht përcakton rastet kur tatimpaguesit rregullojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të atillë që ligjrisht t'i shmangen pagesës së tatimit.

Pjesa e nëntë, sqaron dhe përcakton ndëshkimet që aplikohen ndaj tatimpaguesve, të cilët nuk zbatojnë kërkesat e sistemit tatimor në Kosovë.

Pjesa e dhjetë, përcakton llojet e veprave penale, siç janë evazioni tatimor, shfrytëzimi abuziv i pozitës zyrtare nga ana e zyrtarëve të administratës tatimore si dhe dëshmitë në krijimin dhe ruajtjen e librave dhe regjistrimeve tatimore.

Pjesa e njëmbëdhjetë, rregullon të drejtën e tatimpaguesit gjatë procesit të ankesave. Tatimpaguesi ka të drejtë të bëjë ankesë ndaj vendimeve të administratës tatimore.

Pjesa e trembëdhjetë, flet për konfidentalitetin. Kjo pjesë saktëson se administrata tatimore duhet të konsiderojë dhe ta ruajë si konfidentalitet informacionin personal të marrë nga tatimpaguesit, me përjashtim të rasteve kur tatimpaguesi autorizon lëshimin e të dhënave të tij.

Në përfundim të arsytimit, ministri Ali Sadria i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj, dhanë edhe këta deputetë: **Berat Luzha, Gani Prekopuca, Sebahate Krasniqi dhe Ramadan Kelmendi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë këtë projektligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----77;

Kundër----- 0;

Abstenime---0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për administratën tatimore dhe procedurat. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin për Ekonomi dhe Financa** – komision raportues – ta shqyrtonin këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për teatrin

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Behxhet Brajshori: Projektligji për teatrin përcakton bazat dhe parimet e organizimit, drejtimit dhe zhvillimit të teatrit si formë e të shprehurit artistik dhe të zhvillimit të sistemit teatror në Kosovë.

Me këtë projektligj krijohen kushtet për një zhvillim më të avancuar dhe më të qëndrueshëm të artit skenik në Kosovë. Janë përcaktuar normat dhe kriteret e formimit të një institucioni teatror me dispozita të hollësishme për organizim të brendshëm, programimin e punës dhe repertoarit teatror, mënyrën e sigurimit të mjeteve për punë dhe veçoritë tjera të organizimit të teatrit si institucion publik.

Me kapitull të veçantë është përcaktuar statusi i Teatrit Kombëtar, si institucion i nivelit qendror i artit teatror të Kosovës, që kultivon vlera të dramaturgjisë kombëtare dhe asaj botërore.

Gjithashtu Teatri Kombëtar i Kosovës dhe Teatri i Gjakovës dhe ai i Gjilanit bëhen teatro me ansambël rezident dhe realizojnë repertoar të verifikuar e të qëndrueshëm artistik dhe obligohen që shfaqjet e tyre t'i distribuojnë edhe nëpër teatro tjera të Kosovës.

Dispozitat ligjore për qeverisjen e Teatrit Kombëtar, aplikohen po ashtu në mënyrë përkatëse edhe në organizimin dhe funksionalizimin e teatrove tjera publike, ndërsa për teatrot private dhe trupave teatror është lënë hapësirë më fleksibile si në procedurën e formimit të tyre ashtu edhe për ushtrimin e veprimtarisë së tyre teatrore.

Parashihen edhe format e financimit të veprimtarive teatrore në Kosovë.

Projektligji rregullon edhe statusin e shtëpive të kulturës, të cilat shndërrohen në qendra të kulturës dhe të artit.

Ky projektligj promovon një koncept bashkëkohor dhe funksional për teatrin.

Në përfundim të arsytimit, ministri Behxhet Brajshori i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj i dhanë edhe këta deputetë: **Mevlyde Saraçi, Lirak Çelaj, Sabit Rrustemi, Bujar Dugolli dhe Gani Sdaik**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë këtë projektligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----77;

Kundër----- 0;

Abstenime--- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për teatrin. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin për Kulturë, Rini dhe Sporte** – komision raportues – ta shqyrtonin këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur séancën e sotme në orën 13:10 minuta.

Vazhdim i seancës më 9 shator 2004

Séance i vazhdoi punimet në orën 10:00.

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendi, kurse e ndihmoi **Bajram Kosumi**, anëtar i Kryesisë.

Në seancë ishin të pranishëm 85 deputetë.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financimin e partive politike në Kosovë

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri Bajram Rexhepi: Me këtë projektligj rregullohet një fushë e cila deri më tani ka qenë sipërfaqësisht e rregulluar por jo në tërësi e precizuar me rregulla moderne dhe dispozita të cilat në tërësi e mbulojnë fushën në fjalë. Zbratësia juridike, e cila ka mbretëruar për shkak të mungesës së ligjit përkatës, me miratimin e këtij projektligji plotësohet ajo zbratësirë.

Projektligji përfshin gjithsej 20 nene. Në mënyrë komplekse rregullohet tërë problematika e financimit të partive politike, duke filluar nga dispozitat themelore ku parashihen: rregullat dhe parimet e përgjithshme të financimit të partive politike; rregullohet aspekti i burimeve financiare; ndihmat financiare për fushatat zgjedhore; lejimi dhe ndalimi i ndihmave financiare; përgjegjësia financiare gjatë fushatave zgjedhore; donacionet dhe rregullat që përcaktojnë në mënyrë precize shumat e tyre, mënyrat dhe format e mbledhjes së mjeteve financiare; përgjegjësia për shfrytëzimin e këtyre mjeteve financiare; publikimi i shfrytëzimit të mjeteve financiare; obligimet e kandidatëve për deputetë dhe këshilltarë; obligimet e mbajtjes së dosjeve dhe kontrolli i jashtëm financiar; regjimi ligjor i të ardhurave të partive politike; kontrolli i brendshëm; dispozitat ndëshkimore; si dhe pjesa e fundit e këtij ligji – dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Në përfundim të arsyetimit, kryeministri i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj, dhanë edhe këta deputetë: **Fatmir Rexhepi, Gani Koci, Bajram Kosumi dhe Gani Sadik**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë këtë projektligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----76;

Kundër----- 0;

Abstenime----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për financimin e partive politike. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin për Ekonomi dhe Financa** – komision raportues – ta shqyrtonin këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimin privat në shëndetësi

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja Resmije Mumxhiu: Projektligji për veprimtarinë private në shëndetësi, krijon bazën e domosdoshme ligjore që do të mbështesë zbatimin e Ligjit për shëndetësi të Kosovës, zhvillimin e sektorit në shëndetësi, si dhe reformat e filluara në sektorin e shëndetësisë.

Legjislacioni ekzistues, nuk ka siguruar kornizë të qëndrueshme ligjore për ta realizuar këtë qëllim. Rezultat i kësaj ka qenë hapja e pakontrolluar e institucioneve private shëndetësore ndaj të cilave nuk ka ekzistuar asnjë mbikëqyrje profesionale. Njëkohësisht, të drejtat e qytetarëve në procesin e shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore nuk kanë qenë të mbrojtura.

Projektligji u siguron hapësirë ligjore për përfshirje të gjerë shoqërisë civile në procesin e sigurimit të të drejtave dhe përgjegjësive si dhe institucioneve private shëndetësore edhe ofruesve privat dhe të qytetarëve në kujdesin shëndetësorë.

Ky projektligj përmban nëntë kapituj të organizuar në 30 nene. Kapituj përbërës të këtij Projektligji janë:

Kapitulli i parë, përfshinë përkufimet bazike që dalin nga Ligji për shëndetësi të Kosovës. Kapitulli i dytë, përcakton kushtet për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi dhe të drejtat e obligimet e punëtorëve privat shëndetësor.

Kapitulli i tretë, përcakton nocionet e përgjithshme për themelimin, aftësimin dhe obligimet e institucioneve private shëndetësore.

Kapitulli i katërtë, përcakton standardet e domosdoshme të cilat duhet përmbajtur institucionet dhe punëtorët shëndetësor.

Kapitulli i pestë, përcaktohet roli i Ministrisë së Shëndetësisë në raport me zhvillimin e politikës së sektorit privat, përpilimit të normave dhe standardeve për institucionet shëndetësore dhe rolin mbikëqyrës të saj.

Kapitulli i gjashtë, përcakton themelimin, rolin, funksionin, detyrat, përbërjen, udhëheqjen dhe financimin e Bordit për licencimin e institucioneve shëndetësore private.

Kapitulli i shtatë, përcatohen detyrat dhe përbërja e komisioneve për vlerësimin e përmbushjes së kushteve teknike dhe profesionale për licencimin e institucioneve dhe procedurat për licencimin e tyre.

Kapitulli i tetë, përcakton llojet dhe objektivat e mbikëqyrjes, si dhe dispozitat disiplinore dhe ndëshkimore.

Kapitulli i nëntë, përfshinë dispozitat kalimtare me të cilat përcaktohen obligimet e Ministrisë për të nxjerrë akte përkatëse ligjore dhe nënligjore të institucioneve dhe personave të tjerë juridik dhe fizik, të cilët në pajtim me këtë ligj ushtrojnë veprimtari private shëndetësore.

Në përfundim të arsyetimit, ministrja Resmije Mumxhiu i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj, dhanë edhe këta deputetë: **Nafije Gash, Fetije Këpuska, Teutë Hadri, Zylfije Hundozi dhe Nurishahe Hulaj**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë këtë projektligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----84;

Kundër----- 0;

Abstenime----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për shërbimin privat në shëndetësi. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin për Shëndetësi** – komision raportues – ta shqyrtonin këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtaritë kërkimore - shkencore

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Rexhep Osmani: Kosova ka pasur nevojë të nxirrej një ligji për veprimtarinë shkencore-kërkimore edhe më parë. Ka qenë nevojë e kahershme, por tani është më se e domosdoshme, sepse në këtë fazë gjendemi në procese të periudhës transitore dhe për shoqërinë kosovare janë rrethana krejtësisht të reja.

Projektligji përmban shumë risi krahasuar me legjislacionin e mëparshëm. Veprimtaria kërkimore-shkencore paraqet punën krijuese sistematike që ndërmerret me qëllim të arritjes së njohurive të reja dhe shfrytëzimit të tyre në praktikë, në pajtim me zhvillimet e proceseve ndërkombëtare.

Projektligji ka një koncept të ri që është në harmoni me strategjinë edhe të arsimit të lartë. Nxjerrja e ligjit për kërkime shkencore është bërë në bazë të modelimit të standardeve ndërkombëtare dhe përcakton dhe rregullon këtë aktivitet përmes parashikimit të procedurave për disiplinim të punës kërkimore shkencore, stimulim, koordinim dhe planifikim, duke patur parasysh kushtet ekonomike, politike dhe shoqërore të Kosovës dhe rrethinës së saj.

Me këtë ligj formohet Këshilli Kombëtar për kërkime shkencore, një bord këshilldhënës i cili shqyrton dhe propozon përparësitë e zhvillimit të shkencës dhe hulumtimet kërkimore-shkencore në Kosovë.

Të gjitha institucionet shkencore mund të krijojnë njësi të kërkimit shkencor, të cilat i përgjigjen përgatitjes së propozimeve të projekteve dhe të përcjelljes së zbatimit të tyre.

Po ashtu krijohet një mundësi e re e bashkëpunimit të institucioneve të arsimit të lartë që, së bashku me institucionet shkencore, mund të formojnë Qendrën e kërkimeve shkencore me karakter referal shkencor për të gjitha institucionet e shkollimit të lartë dhe për institucionet shkencore.

Në përfundim të arsyetimit, ministri Rexhep Osmani i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë projektligj i dhanë edhe këta deputetë: **Sabri Hamiti, Dritë Statovci, Bujar Dugolli, Behxhet Brajshori, Exhlale Saliu, Fetije Këpuska dhe Ramadan Kelmendi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë këtë projektligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----85;

Kundër----- 0;

Abstenime---0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për veprimtaritë shkencore-kërkimore. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin për Arsim, Shkencë dhe Teknologji** – komision raportues – ta shqyrtonin këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patentime

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ali Jakupi: Kosovës i mungojnë dispozitat ligjore për rregullimin e çështjeve të patentimit. Me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillim ekonomik si dhe për zhvillim në përgjithësi, nevojitet të krijohen mundësi për shpikjen e inovacioneve, me të cilat stimulohen teknologjitë dhe të arriturat tekniko-shkencore.

Projektligji është i hartuar në 17 kapituj, me gjithsej 81 nene.

Në këtë projektligj janë dhënë definicione për shpikje të patentueshme, për inovacione, shkallën e risive dhe zbatueshmërinë e tyre industriale. Janë precizuar lëndët që mbrohen me patent dhe ato janë shpikjet që kanë të bëjnë me produktet që përbëhen nga materiali biologjik ose që përmban material biologjik, procesin në të cilin prodhohet, përpunohet ose përdoret ai material biologjik si dhe materiali biologjik i izoluar nga mjedisi i tij natyror, ose që prodhohet në procese teknike madje edhe kur më herët ka ndodhur në natyrë.

Me këtë projektligj mbrohen shpikësi dhe e drejta e njohjes, e drejta e patentës që i përket shpikësit ose trashigimtarit të ligjshëm, aplikuesit për patent.

Rregullohet procedura e zbatimit për dhënien e patentit. Për kryerjen e këtyre punëve definohen dokumentet që duhet aplikuesi t’i dorëzojë në zyrën përkatëse pra në Ministrinë së Tregtisë dhe Industrisë. Çështjet lidhur me të drejtat e përparësisë, si dhe kushtet për njohjen e së drejtës së përparësisë rregullohen në mënyrë taksatative përmbajtja e aplikimi të patentit, duke pëfshirë përshkrimin e shpikjes, kërkesat e patentimit e tjera. Projektligji përfshin të drejtat ekskluzive lidhur me patentimet në fushën e bioteknologjisë, të drejtat nga aplikimi i publikuar për patent, masat dhe të drejtat ekskluzive të pronarit të patentës, kontrata e licencës për bartje të të drejtave.

Në Projektligj përcaktohen afati i patentave dhe pagesa e mirëmbajtjes, përfundimi i patentës para afatit, ndryshimet në patent, ndryshimi në pronësi.

Në një kapitull të veçantë bëhet fjalë për licencat, përkatësisht për licenca të detyrueshme, kushtet për të cilat jipet licenca e detyrueshme.

Në dispozitat përfundimtare parashihen rivendosja e të drejtave, përfaqësimi para zyrës kompetente, përfaqësuesit e pronësisë industriale, aplikimet për patent dhe patentat e lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në përfundim të arsyetimit ministri Ali Jakupi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj, dhanë e dhe këta deputetë: **Blerim Baruti, Nerxhivane Dauti dhe Bujar Dugolli**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë projektligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----84;

Kundër----- 0;

Abstenime--- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për patentime. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin për Tregti dhe Industri** – komision raportues – ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tubimet publike

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri Bajram Rexhepi: Nevoja e rregullimit të sferës së tubimeve publike që është një ndër kategoritë juridike të të drejtave të njeriut për ta ushtruar të drejtën e tubimit, të shprehjes së fjalës së lirë, të brengës politike, sociale, kombëtare, kulturore ose për shënimin e datave të rëndësishme në njërën anë, dhe rregullimi i tyre në mënyrë dhe procedurë të drejtë për të arritur që të mbulohen ligsisht veprimet në fushën e tubimeve publike.

Me këtë projektligj krijohen dhe garantohen të drejtat dhe kushtet që qytetarët përkatësisht organizatorët, të ushtrojnë dhe të shfrytëzojnë të drejtën e tyre të tubohen lirshëm për të shprehur mendimin e tyre për kategori të veçanta të të drejtave që ata konsiderojnë se u janë shkelur apo rrezikuar, të shprehin mendimin e tyre për gjendjen ekonomike, sociale, kulturore, sportive, të organizojnë kremtimin dhe shënimin e ngjarjeve të rëndësishme në Kosovë apo për çështje të tjera me interes të përgjithshëm.

Projektligji arrin t’i garantojë: të drejtën e organizimit dhe të pjesëmarrjes në tubime publike pa marrë parasysh përkatësinë racore, kombëtare, bindjet politike, gjinore ose të kategorive të ndryshme sociale; cakton kufizimin në raste të veçanta kur këto tubime mund të shfrytëzohen për dëmtimin e vlerave të përgjithshme; cakton obligime ligjore për organizatorin; krijon procedurë përkatëse që garanton jodiskriminim në raste të lajmërimit të tubimeve publike; siguron të drejtat dhe obligimet e autoriteteve përkatëse

lajmërimin të tubimeve publike; siguron të drejtat dhe obligimet e autoriteteve përkatëse lidhur me lejimin apo refuzimin e mbajtjes së një tubimi publik duke siguruar edhe të drejtën e ankimit kundër vendimeve të tilla.

Në përfundim të arsyetimit kryeministri Bajram Rexhepi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lighur me këtë projektligj, dhanë e dhe këta deputetë: **Kolë Berisha, Hydajet Hyseni, Bujar Dugolli, Remzije Nimani dhe Arsim Bajrami**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë këtë projektligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----85;
Kundër----- 0;
Abstenime----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për patentime. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin për Shërbime Publike** – komision raportues – ta shqyrtonin këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e afërta

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Behxhet Brajshori: Me këtë projektligj synohet të sigurohet rregullimi i plotë, bashkëkohor dhe i efektshëm i autorit dhe të drejtat e afërta.

Rregullimi ligjor i këtyre të drejtave është pjesë përbërëse e kodifikimit të pronës intelektuale.

Projektligji përfshin të drejtën e autorit dhe të drejtat e afërta, rregullimi i të cilave kërkon të kodifikohet me ligj në përputhje të plotë edhe me praktikën bashkëkohore ndërkombëtare.

Projektligji konsiston në kodifikimin e 7 degëve të veprimit juridik: të drejtën e autorit; të drejtën e interpretatorit; të drejtën e prodhuesit të fonogramit; të drejtën e producentit të filmit; të drejtën e prodhuesit të emisionit radioteleviziv; të drejtën e prodhuesit të bazës së të dhënave dhe të drejtën e botuesit.

Projektligji rregullon ndaras këto shtatë degë juridike, si dhe përcakton rregullat e përbashkëta siç është administrimi i të drejtave dhe mbrojtja e të drejtave.

Në Projektligj janë konceptuar dispozita të veçanta për disa lloje të veprave të autorit, që përngaan ndërlíkueshmëria e përmbajtjes e subjekteve krijuese të të drejtës së autorit përkatësisht titullarit të së drejtës si dhe kufizimeve të së drejtës së autorit paraqesin

veçanti. Në këtë kontekst, jepen përkufizime për vepra audiovizuale, programe kompjutorike, vepra nga marrëdhënia e punës e të tjera.

Të drejtat e interpretatorëve, të drejtat e prodhuesve të fonogrameve, të drejtat e producentëve të filmit, të drejtat e organizatave radiotelevizive zënë gjithashtu vend meritor për arsye të rolit dhe pozicionit që kanë këto organizata në shfrytëzimin e veprave të autorit rrespektivisht sajimin e emisioneve të veta, kurse të drejtat e prodhuesve të bazave të të dhënave përbëjnë një kapitull të veçantë në këtë propozimligj.

Për cenimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të afërta është konceptua mbrojtja gjyqësore, që parasheh mbrojtjen e titullarit në rast të shkeljes së të drejtës ekskluzive të tij.

Në Projektligj janë shtjelluar rregullat e përgjithshme që u përkasin personave të huaj përkatësisht mbrojtjes të së drejtës së autorëve, të interpretatorëve dhe të bartësve të tjerë të këtyre të drejtave.

Në përfundim të arsyetimit ministri, Behxhet Brajshori, i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj, dhanë edhe këta deputetë: **Liral Çelaj, Sabit Rrustemi, Bujar Dugolli dhe Gani Sadik**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë këtë projektligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----85;

Kundër----- 0;

Abstenime----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për patentime. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve** – komision raportues – ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen e të papunësuarve

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ahmet Isufi në fillim të arsyetimit të Projektligjit e paraqiti gjendjen e papunësisë në vend. Sipas shënimeve të Minsitrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale janë këto shifra: shkalla e papunësisë në Kosovë është 42.9% ;papunësia afatgjate është 90% e personave që presin punë më gjatë se 12 muaj; të pakualifikuar janë 58%; të rinj që presin punë janë 36% një rritje të punëkërkesve ndër të rinj prej 15% krahasuar me vitin paraprak.

Ministria i marrë një varg masash për sa u përket zbutjes së papunësisë dhe rritjes së punësimit në Kosovë.

Masat që Ministria i ka marrë kanë bërë të mundshme që niveli i papunësisë të zbresë nga 57.1% - që ishte në vitin 2000 dhe 2001, në 42.9% sa kemi tani.

Për të vazhduar në përpjekjet e Ministrisë për zbutjen e papunësisë në Kosovë është hartuar Projektligji për nxitjen e punësimit.

Me fondet që parashihen të formohen me këtë projektligj do të financohen këto politika të punësimit: kompensimi material në bazë të papunësisë; do t'i japim edhe një shtytje shtesë aftësimeve dhe riaftësimeve profesionale; do të jemi në gjendje që t'ua ndihmojmë punëdhënësit përmes substitiuimit të punësimit për një kategori të punëkërkuësve; për një kategori të punëkërkuësve do të negocojmë me punëdhënësit dhe do të participojmë në pagesën e të ardhurave për një periudhë.

Për stimulimin e kërimit të një punësimi intensiv, kemi planifikuar që përmes këtij fondi të nxisim krijimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme përmes mikrokredive.

Të gjitha këto dhe masat tjera shtesë, do t'i implementojmë me një bashkëpunim të frytshëm dhe konstruktiv ndërqeveritar, me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Ministrinë për Tregti e Industri, Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe me partnerët tanë social, Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe Odën Ekonomike

Në përfundim të arsyetimit ministri Ahmet Isufi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj, dhanë e dhe këta deputetë: **Ramdan Kelmendi, Flora Brovina, Zylfije Hundozi dhe Zehra Elezi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë këtë projektligj. Rezultati ishte si vijon:

Për-----84;

Kundër----- 0;

Abstenime--- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen e të papunësuarëve. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin e Punës dhe Mirëqenies Sociale** – komision raportues – ta shqyrtonin këtë projektligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

20. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ahmet Isufi: Projektligji për mbrojtjen e natyrës është i domosdoshëm për rrethanat e krijuara në Kosovë dhe për të vënë nën kontroll institucional çështjet e mbrojtjes së natyrës. Për dallim nga vendet e tjera evropiane, Kosova me sipërfaqje të vogël të tokës që paraqet vlera të mëdha natyrore në pikëpamje të biodiversitetit.

Me këtë rast do të përmendi vetëm disa të dhëna dëshmuese për vlerat e pamohueshme natyrore në Kosovë: Bifurkacioni i lumit Nerodime, që është rasti i dytë në botë; Shpella e Gadimës me sipërfaqen më të madhe të mermerit në botë; Kanjoni atraktiv i Mirushës, që është i dyti në rajon;

Parku Kombëtar Malet e Sharrit, që është shembull i rrallë i biodiversitetit.

Me mbrojtje ligjore në Kosovë janë 52 zona natyrore, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 46 mijë hektarësh. prej të cilave 39 mijë hektar i takojnë Parkut kombëtar Malet e Sharrit.

Ligji i ashtuquajtur i aplikueshëm deri tash, që ka mbuluar sferën e mbrojtjes së natyrës, ka qenë larg kërkesave të zhvillimeve moderne në sferën e mbrojtjes së natyrës dhe larg nga kërkesat e legjisllacionit ndërkombëtar.

Projektligji për mbrojtjen e natyrës ka 12 kapituj të zërthyer në 45 nene.

Kapitulli i parë, përmban dispozitat e përgjithshme të mbrojtjes së natyrës. Kapitulli i dytë, përfshin definicionet kryesore të cituara në ligj, me kontekst të veçantë në definicionet e marra nga direktivat evropiane.

Në kapitullin e tretë, përfshihen parimet themelore të mbrojtjes së natyrës.

Kapitulli i katërtë, parasheh dokumentet kryesore për mbrojtjen e mjedisit si strategjinë dhe planin e veprimit për mbrojtje të natyrës.

Kapitulli i pestë, përcakton organet përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës, duke i ndar kompetencat në mes nivelit qendror dhe atij komunal.

Kapitulli i gjashtë, përmban masat e përgjithshme për mbrojtjen e peisazheve të natyrës, masat për mbrojtjen e specieve të florës dhe faunës si dhe të habitateve.

Kapitulli i shtatë, përmban masat e veçanta për mbrojtjen e natyrës, ku definohen zonat e mbrojtura të natyrës dhe menaxhimin e tyre.

Kapitulli i tetë, përfshin dispozitat për mbrojtjen e specieve të rralla të florës dhe faunës, futjen e llojeve të reja ose të zhdukura në Kosovë.

Në kapitullin e nëntë, përfshihen dispozitat e mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji.

Kapitulli i dhjetë, rregullon financimin e punëve për mbrojtjen e natyrës, kryesisht përmes buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe eko-fondit. Kapitulli i njëmbëdhjetë, përmban dispozitat ndëshkimore në rast të shkeljes së këtij ligji.

Në kapitullin e fundit, përfshihen dispozitat kalimtare.

Me këtë projektligj do të krijohet korniza e nevojshme ligjore që do të mundësojë ruajtje efektive të biodiversitetit dhe të peisazheve duke marrë parasysh kërkesat ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit.

Në përfundim të arsytimit ministri Ahmet Isufi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj, dhanë e dhe këta deputetë: **Esad Dauti, Berat Luzha dhe Sebahate Krasniqi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----84;
Kundër----- 0;
Abstenime--- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e natyrës. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor** – komision raportues – ta shqyrtonin këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

21. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin e vulvae të IPVK-së

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri Bajram Rexhepi: Ky projektligj paraqet bazën themelore për ushtrimin e punëve të institucioneve të pavarura vetëqeverisëse të Kosovës dhe organeve tjera të Kosovës, të cilat do të përdorin vulën me përmbajtjen e paracaktuar me ligj. Me të përcaktohen se cilat janë organet që do të përdorin vulën gjatë kryerjes së punëve administrative.

Projektligji përcakton në mënyrë të saktë përmbajtjen e vulës dhe format e tyre.

Projektligji përmban kapitujt vijues:

- Dispozitat e përgjithshme;
- Dispozitat themelore; dhe
- Dispozitat kalimtare.

Projektligji përmban gjithsej 21 nene.

Në dispozitat e përgjithshme, përcaktohet qëllimi i nxjerrjes së ligjit, organet dhe autoritetet e tjera të cilat kanë të drejtë në mbajtjen dhe përdorimin e vulës.

Në dispozitat themelore, përcaktohet se çka duhet të përfshihet në përmbajtjen e vulës, formën e vulës, gjuha që do të përdoret në vulë, dimensionet e vulës, përdorimi i vulës së thatë, përcaktimi i vendit se ku duhet të mbahet gjegjësisht ruhet vula, obligimin e organeve që do t’i përdorin vulat, me sigurimin e përputhshmërisë së plotë të përmbajtjes dhe formës së paracaktuar me këtë ligj.

Në përfundim të arsyetimit kryeministri Bajram Rexhepi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj, dhanë edhe këta deputetë: **Kolë Berisha, Hydajet Hyseni dhe Bujar Dugolli**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----84;
Kundër----- 0;
Abstenime----0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për përdorimin e vulave të IPVK-ve. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin për Shërbime Publike** – komision raportues – ta shqyrtonin këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

22. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për “Gazetën zyrtare” të Kosovës

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Kryeministri Bajram Rexhepi: Parimi i sundimit të ligjit ka qenë tradicionalisht i institucionalizuar mbi parimet fundamentale ligjore, siç janë ligjshmëria, drejtësia, parashikueshmëria dhe transparenca. Organet për nxjerrjen e ligjeve duhet të ndërmarrin disa masa legjislative, në mënyrë që parimet e ligjshmërisë, drejtësisë, parashikueshmërisë dhe i transparençës të mund të ushtrohen si të drejta të të gjithëve. Në bazë të standardeve unike të miratuara ligji duhet të publikohet në bazë të së drejtës për qasje, me publikimin zyrtar të akteve ligjore. Për ta krijuar dhe për të ushtruar parime të tilla botimi i “Gazetës zyrtare” në letër dhe në formë elektronike është një kusht i pazëvendësueshëm.

Ky projektligj përbëhet nga gjithsej 10 nene dhe është i strukturuar si vijon:

Në kreun e parë përfshihen dispozitat e përgjithshme, përkufizimi i nocionit gazetë zyrtare dhe nocioni i titullit.

Në kreun e dytë përfshihet përmbajtja e ligjit dhe aktet juridike të cilat do të botohen në gazetën zyrtare të Kosovës.

Në kreun e tretë përcaktohen gjuhët në të cilat do të botohet gazeta zyrtare.

Gazeta zyrtare e Kosovës do të botohet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Në kreun e katërt rregullohet çështja e botimit të gazetës zyrtare.

Në kreun e pestë rregullohet çështja e zyrës së menaxhimit të “Gazetës zyrtare” dhe çështja e përgjegjësisë.

Në kreun e gjashtë rregullohen çështja e çmimit dhe e shpërndarjes së “Gazetës zyrtare”.

Në kreun e shtatë përcaktohet mënyra e financimit. Financimi i “Gazetës zyrtare” të Kosovës do të bëhet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës

Në kreun e tetë rregullohet çështja e ankesave.

Në kreun e nëntë rregullohet çështja e zbatimit të ligjit.

Në kreun e dhjetë rregullohet çështja e hyrjes në fuqi të këtij projektligji.

Në përfundim të arsyetimit kryeministri Bajram Rexhepi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj, dhanë edhe këta deputetë: **Kolë Berisha, Hajredin Kuçi, Bujar Dugolli, Gani Sadik dhe Mahir Jakhillar**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----68;

Kundër----- 0;

Abstenime--- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për “Gazetën zyrtare” të Kosovës. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe **Komisionin për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kushtetutë të Përkohshme** – komision raportues – ta shqyrtonin këtë projektligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

23. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për librat amzë

Kryetari e ftoi sponsoruesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Jakup Krasniqi: Nevoja për regullimin e lëmisë së shërbimeve të regjistrimit civil, krijimin e kushteve, hapësirave dhe infrastrukturës adekuate ligjore për krijimin e një sigurie dhe procedure për shfrytëzimin e tyre në të mirë të përgjithshme, miratimi i këtij projektligji është përgjegjja më e mirë ndaj kërkesave tona. Me këtë përfitojnë qytetarët në njërën anë dhe duke siguruar një bazë të mirë të të dhënave që shërbejnë në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, politike dhe sociale.

Me këtë projektligj krijohen dhe garantohen kushtet dhe procedurat më të avancuara të regjistrimit të të dhënave të lindjes, të vdekjes, të martesës dhe fakte relevante lidhur me to.

Objekt dhe qëllim i rregullimit, sipas dispozitave të këtij ligji, është: a) Përcaktimi i librave amzë, si p.sh. libra amzë të të lindurve, librat amzë të të martuarve dhe librat amzë të të vdekurve; b) Përcaktimi i një procedure koherente jodiskriminuese dhe të afatizuar për regjistrimin e fakteve të gjendjes civile dhe c) Krijimin e kushteve dhe kriterëve për ripërtëritjen e librave amzë që janë zhdukur.

Projektligji do të zgjidhë probleme në këto fusha: a) Projektligji për librat e amzës ofron zgjidhje konkrete dhe të avancuara për çështjet që i referohen kësaj sfere; b) Rritë efikasitetin dhe shpejton shërbimet për qytetarët; c) Nxitë qytetarët për ofrimin e të dhënave të sakta dhe me kohë mbi faktet e gjendjes civile; d) Ndihmon në ngritjen e infrastrukturës së bazës të të dhënave për qytetarët e Kosovës dhe e) Shpejton procedurën e pajisjes së qytetarëve me dokumente përkatëse.

Në përfundim të arsyetimit ministri Jakup Krasniqi i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj.

Kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj, dhanë edhe këta deputetë: **Niman Alimusaj, Nerxhivane Dauti dhe Naim Maloku**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

